

SHKOLLA FILLORE KOMUNALE „FAN NOLI,, F.TREBOSH



RAPORT PËR VETEVALUIMIN E SHKOLLËS 2023/2024-2024/2025

Tetor 2025

PËRMBAJTJA

Komisioni shkollor për vetevaluimin	3
Letërnjoftimi i shkollës	4
Misioni dhe vizioni	8
Hyrje	9
Përshkrim i sferave, indikatorëve, temave dhe niveleve	10
Raport për vetevaluimin e shkollës	14
Sfera1.Planifikim, mësim dhe nxënie	25
Sfera2.Arritjet e nxënësve	33
Sfera3.Klima shkollore	41
Sfera4.Menaxhimi, udhëheqja dhe hartimi i politikave	61
Përfundim	69

Komisioni shkollor për vetevaluimin e shkollës 2023/24 - 2024/25

1. Gjilten Idrizi – Pedagog
2. Semira Esati – Psikolog
3. Xhemadije Iseni – Edukator special dhe rehabilitator
4. Rahim Fazlija – Arsimtar
5. Sedat Rushani – Prind

Letërnjoftimi i shkollës

Shkolla fillore komunale “ Fan Noli” ka një histori të bujshme. Mësimet e para nxënësit e Fshatit Trebosh i kanë ndjekur në shtëpi private nën udhëheqjen e arsimtarit të parë Jonuz Abdullahit rreth vitit 1948/ 1949, më pastaj nxënësit e f. Trebosh mësimet i kanë vijuar në sh.f. “ Skenderbeu” të f. Poroj. Duke i pa vështërsitë e udhëtimit në këmbë të fëmijëve të tyre, prindët e këtyre nxënësve dhe bashkëfshatarët e tyre marrin iniciativë për ndërtimin e objektit të shkollës . Në vitin 1950 banorët e fshatit ndërtojnë objektin e shkollës dhe në vitin shkollor 1950-1951 fillon mësimi i rregullt katërvjeçar me gjithësej 14 nxënës prej klasës së parë e deri në klasën e katërt. Në fillim kjo Shkollë emrohej me emrin “Suksesi” pastaj nga viti 1960 kjo shkollë bëhet si shkollë periferike e sh.f “Bratstvo Edinstvo” – Tetovë.

Me që në fshat nuk kishte kushte për zhvillimi e mësimi deri në klasën e tetë, nxënësit ndiqnin mësimin që nga klasa e pestë e deri në klasën e tetë në shkollën qendrore “Bratstvo Edinstvo” në Tetovë. Përsëri ishin banorët e fshatit që ngritën iniciativën dhe ndanë mjete nga buxheti i tyre për të ndërtuar objektin ku do të mësohej deri në klasën e tetë (nëntë), pra arsimin fillor nxënësit e këtij fshati do ta kryenin në fshatin e tyre. Shkolla e re u hap në vitin shkollor 1986 -1987.

Në këtë shkollë mësimin e tyre ndoqën edhe nxënësit e Pallaticës, të cilët më parë mësonin në shkollën e f. Zhelinë. Pas mëvetësimit nga shkolla “Bratstvo Edinstvo” e Tetovës, kjo shkollë emërohet pa dëshirën e kolektivit, me direktiva nga ish Komiteti i arsimit me emrin “Hristo Antevski”, mirëpo pas ndryshimeve politike në vitin 1994 punëtorët e kolektivit ngritën iniciativën për ndërimin e emrit dhe këtë shkollë e emërtuan me emrin e Rilindasit shqiptar “ Fan Noli”.

Në vitin 1996 hapet shkolla në f. Pallaticë. Nxënësit e kësaj shkollë më nuk udhëtojnë që mësimet e tyre ti ndjekin në f. Trebosh, por që nga ky vit në këtë shkollë mësojnë nxënësit e f. Pallaticë. Nga janari i vitit 2008 shkollës qendrore të f. Trebosh i bashkangjitet edhe shkolla periferike e f.

Uzurmisht, nxënësit e së cilës mësimet i ndjekin deri në klas të pestë e nga klasa e gjashtë të njëjtit vazhdojnë që mësimet ti ndjekin në shkollën e f. Shemshovë.

Gjatë gjithë kësaj periudhe të procesit edukativo-arsimor nga gjiri i kësajë shkolle e kanë ndjekur shkollimin e mesëm dhe atë të lartë një numër i madh nxënësish, që sot ne si punëtor të krenohemi se në këtë mes veprojnë dhe punojnë arsimtar, profesor, mjek, inxhinjer, jurist, ekonomist dhe shumë profesione të tjera.

1. TË DHËNAT E PERGJITHSHME TË SHKOLLËS

Të dhëna për shkollën

SHFK “Fan Noli” f. Trebosh – Pallaticë - Uzurmisht, përfshin nxënës prej klasës - **I, II, III, IV, V, VI, VII, VIII dhe IX** .

Emri i shkollës	SHFK “Fan Noli”
Adresa, komuna, vendi	Trebosh, Komuna e Zhelinës
Telefoni	071/229/978
e-maili	ou-fannoli-trebosh-zhelino@schools.mk
Ueb faqja	www.fannoli.edu.mk
Facebook page	https://www.facebook.com/SHFK”Fan noli/
Verifikimi- numri dhe akti	16-244
Viti i verifikimit	1987
Themeluar nga	Këshilli i Komunës së Zhelinës
Gjuha në të cilën mbahet mësimi	Shqip
Viti i ndërtimit	1987
Statusi i eko shkollës (flamur i gjelbërt, niveli i argjendtë dhe ai bronze)	/ /

Samie Rakipi – Drejtor
 Gjilten Idrizi - Pedagog
 Rahim Fazlija - anëtarë nga Këshilli i arsimtarëve
 Imrane Shabani – anëtarë nga Këshilli i arsimtarëve
 Erlinda Saiti– anëtarë nga Këshilli i arsimtarëve
 Muaxher Haruni - kryetar nga aktivi shoqëroro- gjuhësor
 Imrane Shabani – kryetar i aktivitet nga shkencat matematiko-
 natyror
 Rahim Fazlija - kryetar i aktivitet profesional i sportit, teknikës
 dhe artit
 Fitnete Arslani - kryetar e aktivitet profesional të grupit klasorë I-
 III
 Merita Izairi- kryetar e aktivitet profesional të grupit klasorë IV-V

Organet drejtuese, organet profesionale dhe organizimi i nxënësve në shkollën fillore

Anëtarët e Këshillit të shkollës (Emri dhe mbiemri)

Rahim Fazlija - përfaqësues nga arsimtarët
Imrane Shabani – përfaqësues nga arsimtarët
Erlinda Saiti –përfaqësues nga arsimtarët
Sedat Rushani – përfaqësues nga prindërit (kryetar)
Binakali Abdi – përfaqësues nga prindërit
Bedri Ali – përfaqësues nga prindërit
Shaban Nuredini –përfaqësues nga Komuna
Rajana Kadriu– kryetare e parlamentit të nxënësve

Aktivitet profesionale (llojet)	Aktivitet profesional i grupit klasor – Qemal Selmani
	Aktivitet profesional i lëndëve shoqërore gjuhësor – Muaxher Haruni
	Aktivitet profesional i lëndëve matematiko-natyror – Imrane Shabane
	Aktivitet profesional i sportit, teknikës dhe artit – Rahim Fazlija
Këshilli i arsimtarëve (numri i arsimtarëve)	59

Anëtarët e ekipit inkluziv i shkollës (emër dhe mbiemër)	1. Samie Rakipi– drejtor 2. Gjilten Idrizi– pedagog 3. Xhemadije Iseni – Edukatore speciale dhe rehabilitator 4. Rahim Fazlija – arsimtar 5. Shpresa Kamberi – arsimtare 6. Shaban Zeqiri– prind 7. Emira Ethemli– prind
Bashkësia e klasëve (numri i nxënësve)	23
Parlamenti i nxënësve (numri i nxënësve, emër dhe mbiemër i kryetarit)	Rajana Kadriu
Avokati i nxënësve (emër dhe mbiemër)	Fjolla Saiti
Anëtarët e Eko shkollës (numri i arsimtarëve)	7

Misioni i shkollës

Roli kryesor dhe misioni i kësaj shkolle është të ofrojë edukim dhe arsim për nxënësit e të gjitha bashkësive etnike, duke u bazuar në konceptin e arsimit fillor nëntëvjeçar. Shkolla implementon programet e reja mësimore dhe i pajis nxënësit me njohuri, shkathtësi dhe aftësi që të përballojnë me sukses sfidat që dalin nga procesi edukativo-arsimor.

Misioni i shkollës synon aftësimin dhe edukimin e nxënësve të të gjitha bashkësive etnike, duke kultivuar sjellje shoqërore përgjegjëse ndaj shkollës, shokëve dhe shoqeve, si dhe ndaj mjedisit ku jetojnë dhe veprojnë. Ky mision mbështetet në parimet demokratike, tolerancën, mirëkuptimin e ndërsjellë, nxitjen e iniciativave, konstruktivitetin dhe zhvillimin e aftësive individuale.

Duke marrë parasysh rolin e rëndësishëm edukativo-arsimor të shkollës dhe ndikimin që ajo ka në mjedisin shoqëror, shkolla mbetet e hapur për bashkëpunim me të gjitha palët e interesuara. Veçanërisht, synojmë të forcojmë bashkëpunimin me komunitetin lokal, prindërit, komunën dhe institucionet relevante, me qëllim përmirësimin e procesit edukativo-arsimor dhe mbështetjen e vazhdueshme të nxënësve.

Vizioni i shkollës

Vizioni i shkollës sonë bazohet në disa komponente kyçe, që lidhen me zhvillimin e programeve sa më cilësore edukativo-arsimore, ngritjen profesionale të stafit përmes kualifikimeve dhe rikualifikimeve të vazhdueshme, si dhe aftësimin permanent të trupës arsimore në përputhje me kërkesat e kohës. Ky vizion përfshin gjithashtu nxitjen e iniciativave individuale dhe kolektive në kuadër të organeve, organizatave, këshillave prindërorë, si dhe bashkëpunimin me subjektet komunale dhe republikane që veprojnë në fushën e arsimit fillor dhe më gjerë. Një rëndësi të veçantë zë edhe bashkëpunimi i ndërsjellë me mjedisin lokal, Komunën e Zhelinës dhe faktorë të tjerë të brendshëm e të jashtëm.

Duke u nisur nga gjendja momentale në shkollë, rezultatet e deritanishme, puna dhe angazhimi profesional i kuadrit arsimor, si dhe rrethanat pozitive që na rrethojnë, vizionin e shkollës sonë e definojmë si imperativ që:

“Të ndërtojë kushte të shkëlqyera për mësim bashkëkohor, duke përdorur forma, metoda dhe mjete moderne të mësimdhënies; të bashkëpunojë vazhdimisht me prindërit e nxënësve; dhe të shërbejë si shembull për gjeneratat e reja të të gjitha bashkësive etnik

Hyrje

Në bazë të Nenit 129, paragrafi 1, 2, 3, 4 dhe 5 të Ligjit për Arsimin Fillor (Gazeta Zyrtare e RMV nr. 161/19 dhe 229/20), drejtori i SHFK “Fan Noli” – f. Trebosh solli vendim për formimin e ekipit për vetevaluimin e shkollës për periudhën 2023–2025. Ekipi për vetevaluim përgatiti raportin për punën e shkollës për periudhën 2023/24–2024/25.

Vlerësimi i vazhdueshëm i kualitetit të punës së shkollës, me qëllim të përmirësimit të punës dhe zhvillimit të vazhdueshëm, është një nga detyrat kryesore të sistemit arsimor. Kualiteti i një shkolle përcaktohet nga disa faktorë, duke përfshirë arritjet e nxënësve, klimën dhe kulturën e shkollës, cilësinë e mësimi dhe nxënies, si dhe politikat e menaxhimit dhe udhëheqjes së shkollës.

Qëllimi i vetevaluimit është që, përmes analizave konkrete të të gjitha sferave të punës së shkollës, të fitohet një pasqyrë reale për cilësinë e punës, përparimin dhe arritjet e shkollës, si dhe për identifikimin e anëve të forta dhe të dobëta, për të cilat do të ofrohen masa të propozuara për përmirësim. Ky dokument paraqet indikatorët kryesorë për vlerësimin e cilësisë së punës së shkollës, me përshkrime të praktikave të mira drejt të cilave duhet të synojnë të gjitha shkollat. Nga analizat e bëra gjatë zbatimit të vetëevaluimit për periudhën 2023/24–2024/25, rezultatet dhe propozim-masat për përmirësimin e cilësisë së procesit edukativo-arsimor i dorëzohen Këshillit të Shkollës, drejtorit të shkollës dhe themeluesit.

Propozim-masat merren parasysh nga Këshilli i Shkollës dhe Drejtori gjatë përgatitjes dhe hartimit të Programit Vjetor të Shkollës dhe Programit Zhvillimor.

Përshkrimi i sferave, indikatorëve, temave dhe niveleve

- **SFERA 1** - Planifikimi, mësimi dhe nxënia
- **SFERA 2** - Arritjet e nxënësve
- **SFERA 3** – Klima shkollore dhe marrëdhëniet në shkollë
- **SFERA 4** - Menaxhimi, udhëheqja dhe hartimi i politikave

Çdo sferë kryesore përmban numër të caktuar indikatorësh për kualitet.

Shemb.Sfera1.Planifikimi, mësimi dhe nxënia i përmban indikatorët për kualitet si vijon:

- 1.1 Planifikimi i mësimdhënësve
- 1.2 Procesi mësimor
- 1.3 Përvojat e nxënësve nga nxënia
- 1.4 Vlersimi si pjesë e mësimi
- 1.5 Aktivitetet dhe garat jashtëshkollore

Secili indikatorë ka numër të caktuar të temave që kanë të bëjnë me aktivitete të caktuar që ndiqet në shkollë.

Shemb. Indikatori

1.3 Përvojat e nxënësve nga nxënia i përfshijnë temat si vijon:

- 1.3.1 Mjedisi dhe atmosfera për nxënie
- 1.3.2 Identifikimi dhe plotësimi i nevojave të ndryshme arsimore të nxënësve

SFERA1. PLANIFIKIM, MËSIM DHE NXËNIE

numri	indikatori	Tema
1.1	Planifikimet e mësimdhënësve	• Mbështetja dhe ndjekja e planifikimeve të mësimdhënësve • Shkëmbimi i përvojave dhe informacionet gjatë planifikimit
1.2	Procesi mësimor	• Realizimi i planeve dhe programeve mësimore • Përzgjedhja e lëndëve mësimore • Përzgjedhja e detyrave, aktiviteteve dhe resurseve • Ndërveprimi mes mësimdhënësve dhe nxënësve dhe nxënësve mes vete • Realizimi i inkluzionit arsimor • Aktivitete për integrimin ndëretnik në arsim
1.3	Përvoja e nxënësve nga nxënia	• Mjedisi dhe atmosfera për nxënie • Identifikimi dhe plotësimi i nevojave të ndryshme arsimore të nxënësve
1.4	Notimi si pjesë e mësimi	• Politika shkollore për notim • Metodat, format dhe instrumentet e notimit • Koeficienti i vazhdimësisë së suksesit të nxënësve • Përdorimi i informacioneve nga vlerësimi i mësimi
1.5	Aktivitete dhe gara jashtë shkollore	• Vëllimi dhe shumëllojshmëria e aktiviteteve të planifikuara dhe të realizuara jashtëshkollore • Përfshirja e nxënësve të të dy gjinive dhe të të gjitha gjuhëve mësimore në aktivitete jashtëshkollore. • Përfshirja e nxënësve në përzgjedhjen dhe planifikimin e punës në aktivitetet jashtëshkollore • Gara

SFERA 2: ARRITJET E NXËNËSVE

2.1	Arritjet e nxënësve	• Ndjekja e arritjeve të nxënësve të të dy gjinive dhe të të gjitha gjuhëve mësimore, sipas lëndëve mësimore dhe sipas periudhave të kualifikimit. • Rezultatet e testimeve eksterne • Identifikimi dhe mbështetja e nxënësve me vështirësi në të nxënë, nxënësve të talentuar dhe nxënësve me aftësi të kufizuara. • Njoftimi i prindërve / kujdestarëve për arritjet e nxënësve
2.2	Masat për përmirësimin e arritjeve	• Rregullsia në mësim • Këshillimi i prindërve / kujdestarëve dhe nxënësve • Përmirësimi i arritjeve të nxënësve përmes mësimin të rregullt dhe plotësues

SFERA 3 : KLIMA SHKOLLORE

3.1	Klima shkollore dhe marrëdhëniet në shkollë	• Reputacioni / imazhi i shkollës • Kodi i Sjelljes • Klima shkollore • Sjellja dhe disiplina në shkollë • Pjesëmarrja e nxënësve në vendimmarrje dhe zgjidhjen e problemeve
3.2	Barazia dhe drejtësia	• Njohja dhe respektimi i të drejtave të fëmijëve • Trajtimi i barabartë dhe i drejtë i të gjithë nxënësve
3.3	Marrëdhënie partneriteti me bashkësinë	• Bashkëpunimi i shkollës me prindërit / kujdestarët • Bashkëpunimi me komunën dhe me bashkësinë urbane

3.4	Kujdesi i përgjithshëm për nxënësit	• Parandalimi dhe mbrojtja nga dhuna • Mbrojtja nga pirja e duhanit, alkooli dhe përdorimi i drogave • Cilësia e ushqimit të ofruar • Higjiena dhe mbrojtja nga sëmundjet • Kujdesi për sigurinë e nxënësve dhe të punësuarve • Kujdesi për nxënësit nga familje të rrezikuara socialisht • Kujdesi për nxënësit me probleme shëndetësore • Kujdesi për mirëqenien socio-emocionale të nxënësve • Ofrimi i ndihmës gjatë procesit të përzgjedhjes për vazhdimin e arsimit
SFERA 4: MENAXHIMI, UDHËHEQJA DHE HARTIMI I POLITIKAVE		
4.1	Menaxhimi dhe udhëheqja e shkollës	• Menaxhimi i shkollës • Udhëheqja e shkollës • Menaxhimi dhe udhëheqja e resurseve • Udhëheqja e kuadrit • Ndjekja dhe përmirësimi i procesit mësimor
4.2	Qëllimet dhe hartimi i politikës shkollore	• Procedurat për hartimin e politikave shkollore • Rezultatet e planifikimit zhvillimor • Planifikimi dhe menaxhimi i buxhetit të shkollës

RAPORT PËR VETEVALUIMIN E SHKOLLËS 2023/2024-2024/2025

Sfera1: Planifikimi, mësimi dhe nxënia

Indikatori	Tema	Përshkruesit
Planifikimi i mësimdhënësve	Mbështetja dhe ndjekja e planifikimeve të mësimdhënësve	Pjesërisht kënaq Shkolla siguron trajnime për mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesionalë për aplikimin e metodave dhe teknikave bashkëkohore në planifikimin e mësimit. Megjithatë, diseminacioni i njohurive nga trajnimet e realizuara nuk bëhet gjithmonë në mënyrë të rregullt tek mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesionalë. Në fillim të vitit shkollor, planifikimet e mësimdhënësve shqyrtohen nga drejtori, bashkëpunëtorët profesionalë dhe/ose nga personat e emëruar nga organet profesionale, por ende nuk ekzistojnë procedura të qarta për ofrimin e mbështetjes dhe udhëzimeve për përmirësimin e tyre.

	• Shkëmbimi i përvojave dhe informacioneve gjatë planifikimit	Shumë mirë Mësimdhënësit, së paku dy herë në gjysmëvjetor, shkëmbejnë përvoja rreth planifikimeve në kuadër të aktiveve profesionale dhe përdorin përvoja profesionale nga media të ndryshme, si dhe nga bashkëpunimi rajonal me shkollat tjera. Si rezultat i këtij shkëmbimi të përvojave dhe shfrytëzimit të burimeve profesionale, planifikimet e një numri të madh të mësimdhënësve janë përmirësuar dukshëm.
--	---	---

Dokumente

Planet dhe programet mësimore të miratuara nga MASH

Standardet Kombëtare për arritjet e nxënësve në fund të arsimit fillor

Burimet e informacionit për vetevaluim përfshijnë:

- Programin vjetor të punës së shkollës
- Planifikimet e mësimdhënësve
- Listat, agjendat dhe raportet nga trajnimet e realizuara
- Procesverbalet dhe listat e mbledhjeve të aktivave profesionale
- Anketat me mësimdhënësit
- Intervistat me drejtorin dhe bashkëpunëtorët profesionalë
- Raportet nga bashkëpunëtorët profesionalë për planifikimet e ndjekura

Procesi mësimor	• Realizimi i planeve dhe programeve mësimore	Shumë mirë Mësimi në klasë dhe në të gjitha lëndët mësimore realizohet rregullisht dhe në vëllimin e parashikuar sipas orarit mësimor. Në rastet e mungesës së mësimdhënësve (p.sh., pushimi i lindjes, pushimi mjekësor etj.), mësimi zhvillohet pa problem me mësimdhënësit zëvendësues, duke siguruar që të mos ndikojë në cilësinë e procesit mësimor..
-----------------	---	---

Procesi mësimor	• Përzgjedhja e lëndëve mësimore	Shumë mirë Aktivitetet dhe lëndët zgjedhore/të lira zhvillohen në përputhje me planet dhe programet mësimore, Doracakun për lëndët e lira zgjedhore në arsimin fillor, si dhe me procedurat e përcaktuara në shkollë. Në këto aktivitete janë përfshirë interesat dhe nevojat e nxënësve.ⁱ
Procesi mësimor	• Përzgjedhja e detyrave, aktiviteteve dhe resurseve	Shumë mirë Të gjithë mësimdhënësit përshtatin detyrat dhe aktivitetet me nevojat individuale arsimore të nxënësve. Në këtë proces, ata përdorin herë pas here burime të ndryshme për nxënie dhe mësim, duke mos u kufizuar vetëm te librat shkollorë dhe literatura shtesë. Resurset në dispozicion përdoren në mënyrë funksionale, duke aplikuar qasje moderne të mësimdhënies, si: mësimi me përvojë, mësimi përmes projektit, mësimi përmes zgjidhjes së problemeve, mësimi përmes lojës, mësimi përmes hulumtimit, si dhe përdorimi i veglave dhe programeve digjitale. Për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore (NVA), përdoren metoda dhe teknika të përshtatura sipas nevojave të tyre individuale.
Procesi mësimor	• Ndërveprimi mes mësimdhënësve dhe nxënësve dhe nxënësve mes vete	Shumë mirë Të gjithë mësimdhënësit sillen me nxënësit në mënyrë që promovon pranimin, respektin, bashkëpunimin dhe mirëkuptimin. Në shumicën e rasteve, mësimdhënësit sigurojnë mundësi të barabarta për përfshirje dhe i përfshijnë të gjithë nxënësit gjatë orëve mësimore. Në pjesën më të madhe të orëve mësimore, ekziston ndërveprim i vazhdueshëm mes mësimdhënësve dhe nxënësve, duke shkuar drejt arritjes së qëllimeve të orës. Për më tepër, zgjedhja e metodave dhe teknikave të aplikuara lejon ndërveprimin mes nxënësve dhe nxit shprehjen e lirë gjatë mësimi.
Procesi mësimor	• Realizimi i inkluzionit arsimor	Shumë mirë Ekipi inkluziv i shkollës dhe ekipi inkluziv i nxënësve janë formuar me Vendim të drejtorit të shkollës. Ata përditësojnë rregullisht përbërjen dhe mandatet, duke marrë parasysh ndryshimet e mësimdhënësve dhe nxënësve me nevoja të veçanta arsimore (NVA). Ekipi inkluziv siguron mbështetje për përpilimin e Planeve Individuale Arsimore (PIA) në të gjitha lëndët, në përputhje me rregullativën ligjore. Për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, aktivitetet mësimore dhe jashtëshkollore realizohen sipas PIA-së dhe/ose programeve të modifikuara, bazuar në rekomandimet e Klasifikimit Ndërkombëtar të Funksionalitetit (KNF). Shkolla bashkëpunon në mënyrë aktive me qendrat kompetente të resurseve për të avancuar mësimin për nxënësit me aftësi të kufizuara.

		Mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesionalë janë të trajnuar për të planifikuar dhe realizuar mësim për nxënësit me NVA. Teknologjia asistive në dispozicion të shkollës përdoret për zhvillimin e nxënësve me NVA. Megjithatë, qasja në shkollë, hapësirat në korridore dhe klasë, si dhe tualetet, nuk janë ende të përshtatura për nevojat e nxënësve me aftësi të kufizuara fizike. Mësimdhënësit vlerësojnë arritjet e nxënësve me NVA në përputhje me qëllimet e planeve individuale arsimore, në bashkëpunim me ekipin inkluziv të nxënësit. Shkolla siguron kushtet për pjesëmarrjen e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në aktivitete jashtëshkollore, duke marrë parasysh interesat e tyre. Nxënësit me aftësi të kufizuara që kanë nevojë për asistencë personale dhe/ose arsimore identifikohen në kohë, dhe dorëzohet kërkesë për mbështetje përkatëse. Kuadri mësimor bashkëpunon me sukses me asistentët arsimorë për të siguruar interesin më të mirë për nxënësin. Ekipi inkluziv gjithashtu punon në orientimin profesional për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore.
	• Aktivitete për Integrimin Ndëretnik në Arsim	Pjesërisht kënaq EISH ndjek realizimin e aktiviteteve INA të PVPSH dhe aktiviteteve të projekteve të mbështetura përmes granteve nga MASH-i. EISH plotëson rregullisht pyetësorët dhe anketat për nevojat e Komisionit për avancimin e INA-s në MASH. Në shkollat që zhvillojnë mësim në disa gjuhë mësimore, ekzistojnë shembuj të aktiviteteve jashtëshkollore të realizuara me grupe nxënësish të balancuara gjuhësisht, të përbërë nga nxënës me gjuhë mësimore të ndryshme (heterogjene).

¹Përfshijmim bëjnë shkollat me një numër të vogël nxënësish në të cilat lista e lëndëve zgjedhore, në marrëveshje me nxënësit (respektivisht me prindërit /kujdestarët etyre), mund të jetë më e kufizuar.

Dokumente

[Koncepti për arsimin fillor](#) (MASH/BZHA, 2020)

[Koncepti për arsimin inkluziv](#) (BZHA, 2020)

[Udhëzues për lëndët e lira zgjedhore në arsimin fillor](#) (DBE, 2021) [Udhëzuesi i punës së ekipit inkluziv shkollor](#) (BZHA, 2018)

[Udhëzues për lëndët e lira zgjedhore](#) (BZHA, 2021)

[Udhëzim për organizimin e orëve të përbashkët amësimore](#) (QMEQ, 2021)

Burimet e të dhënave për vetevaluim përfshijnë:

- Programin vjetor të punës së shkollës
- Orarin e orëve të mësimi dhe e-ditarin
- Evidencën dhe dokumentacionin pedagogjik
- Listat dhe raportet e trajnimeve të realizuara
- Procesverbalet e mbledhjeve të aktivave profesionale
- Anketat me mësuesit, studentët dhe prindërit
- Diskutimet në grupe fokusi me nxënësit, mësuesin dhe prindërit
- Intervistat me drejtorin dhe bashkëpunëtorët profesionalë
- Raportet nga vizitat në orët mësimore
- Zgjidhjet e ekipeve inkluzive të shkollës
- Planet Individuale Arsimore (PIA) të përpiluar dhe programet e modifikuara për nxënësit me nevojë të veçantë arsimore
- Procesverbalet e takimeve të ekipeve shkollorë për inkluzion dhe të ekipeve inkluzive për nxënësit
- Raportet dhe procesverbalet e ekipeve të integritetit shkollor (EISH)

Përvojat e nxënësve nga nxënia	Mësimi dhe atmosfera për nxënie	Pjesërisht kënaq Nxënësit dhe prindërit përjetojnë shkollën si një mjedis të sigurt, megjithatë pjesërisht stimulues, inkluziv, interkulturor dhe motivues. Nxënësit nuk kanë qasje të plotë në materiale të ndryshme për nxënie. Nxënësit vlerësojnë se vetëm në një numër të vogël të orëve mësimi zhvillohet në mënyrë interesante. Gjatë këtyre orëve, disa nxënës shprehin mendimet e tyre në mënyrë të pavarur dhe kritike, bëjnë pyetje dhe nxjerrin konkluzione për atë që mësojnë. Një pjesë e vogël e mësimdhënësve përdor metoda të ndryshme për të motivuar nxënësit gjatë mësimin.
Përvojat e nxënësve nga nxënia	Identifikimi dhe plotësimi i nevojave të ndryshme arsimore të nxënësve	Shumë mirë Kuadri mësimor dhe bashkëpunëtorët profesionalë identifikojnë sistematikisht nevojat dhe pengesat në procesin e nxënies së nxënësve. Gjatë procesit të nxënies, ata ndërmarrin aktivitete për plotësimin e këtyre nevojave dhe/ose për të larguar pengesat që mund të lindin. Disa mësimdhënës, në bashkëpunim me bashkëpunëtorët profesionalë, përdorin teknika të ndryshme interaktive, të cilat mundësojnë që një pjesë e nxënësve me nevoja të ndryshme arsimore të arrijnë qëllimet e planifikuara.

Burimet e të dhënave për vetevaluim përfshijnë:

- Anketat me nxënësit, prindërit dhe mësimdhënësit
- Bisedat në grupe fokusi me nxënësit, prindërit dhe mësimdhënësit
- Bisedat me shërbimin profesional
- Qasja në dosjet e nxënësve
- Qasja në evidencën e bashkëpunëtorëve profesionalë

Notimi si pjesë e mësimit	Politika shkollore e notimit	Shumë mirë Shkolla zbaton politikat e paracaktuara të notimit, duke përfshirë edhe kodin e notimit, me qëllim kryesor mbështetjen e nxënies së çdo nxënësi. Në kuadër të aktivëve profesionalë, shkolla përcakton kriteret e notimit në përputhje me standardet kombëtare të arritjeve. Këto kriteret harmonizohen gjatë aktivëve profesionale dhe mësimeve të përdorin për të vlerësuar nxënësit; nxënësit dhe prindërit janë të informuar për to. Shumica e mësimeve aplikojnë notimin formativ. Të dy format e notimit, formativ dhe sumativ, janë të publikuara dhe transparente për nxënësit.
Notimi si pjesë e mësimit	Metodat, format dhe instrumentet e notimit	Shumë mirë Mësimeve të përdorin metoda, forma dhe instrumente të shumëllojshme për të notuar dhe për të ndjekur vazhdimisht përparimin e nxënësve. Nxënësit përfshihen në procesin e notimit përmes vetënotimit, notimit të ndërsjellë, ndërtimit të kriterëve dhe udhëheqjes së portofoleve. Instrumentet e notimit përditësohen dhe avancohen në bashkëpunim me shërbimin profesional.
Notimi si pjesë e mësimit	Koeficienti i vazhdimësisë së suksesit të nxënësve	Pjesërisht kënaq Koeficienti i vazhdimësisë së suksesit për periudhën e tretë të arsimit, bazuar në tre vitet përkatëse të mëparshme, i përlogaritur si raport mesatar i suksesit të shkollës në gjysmëvjetor dhe në fund të vitit, është më i madh se 0.6 dhe më i vogël se 0.7.
Notimi si pjesë e mësimit	Përdorimi i informacioneve nga notimi në mësim	Shumë mirë Mësimeve të përdorin të gjitha informacionet e marra nga notimi për të përmirësuar planifikimin dhe realizimin e mësimit. Të gjithë mësimeve u japin rregullisht nxënësve informacione kthyes për punën e tyre, diskutojnë për përparimin dhe arritjet e tyre, dhe, sipas nevojës, përfshijnë nxënësit në mësim shtesë ose plotësues.

Dokumente

Standarde kombëtare për arritjet e nxënësve në fund të arsimit fillor (BZHA, 2021)

Kritere për notimin e arritjeve të nxënësve (BZHA)

Burimet e të dhënave për vetevaluim përfshijnë:

- Programin për punën e shkollës
- Orarin për mësim shtues dhe plotësues
- Listat e nxënësve të përfshirë në mësimin shtues dhe plotësues
- Rregulloret për notim dhe avancimin e nxënësve
- Rregullore interne për notimin
- Qasjen në evidencën dhe dokumentacionin pedagogjik
- Instrumentet e përdorura për notim
- Shembuj të punimeve të notuara të nxënësve
- Procesverbalet nga aktivitetet profesionale dhe këshillat e mësimdhënësve
- Anketat dhe intervistat me nxënësit, mësimdhënësit dhe prindërit

Aktivitete dhe gara jashtë shkollore	Vëllimi i llojllojshmërisë së aktiviteteve dhe garave jashtë shkollore	Pjesërisht kënaq Shkolla planifikon, por realizon vetëm pjesërisht aktivitetet jashtëshkollore. Aktivitetet e zhvilluara janë të kufizuara sipas llojit dhe i reflektojnë në mënyrë të mjaftueshme nevojat dhe interesat e nxënësve.
Aktivitete dhe gara jashtë shkollore	Përfshirja e nxënësve me aktivitete jashtëshkollore	Pjesërisht kënaq Një pjesë e vogël e nxënësve janë përfshirë të paktën në një aktivitet jashtëshkollor. Në shkollë, me nxënësit e ciklit të tretë arsimor, janë realizuar aktivitete shoqërore dhe humanitare si pjesë e aktiviteteve jashtëshkollore.

Aktivitete dhe gara jashtë shkollore	Përfshirja e nxënësve në përzgjedhjen dhe planifikimin e aktiviteteve jashtëshkollore	Shumë mirë Një pjesë e konsiderueshme e nxënësve janë të njohur me aktivitetet jashtëshkollore që ofrohen në shkollë. Ky fakt tregon se informacioni mbi aktivitetet arrin të gjithë nxënësit në mënyrë të barabartë. Rekomandimet e mësimdhënësve janë vendimtare për përzgjedhjen e aktiviteteve dhe për planifikimin e përmbajtjeve, gjë që sugjeron se roli i nxënësve në vendimmarrje është i kufizuar. Për përmirësim, shkolla mund të rrisë informimin e nxënësve për aktivitetet jashtëshkollore dhe të përfshijë më shumë nxënës në procesin e zgjedhjes dhe planifikimit të aktiviteteve, duke synuar pjesëmarrje më të barabartë dhe motivim të lartë.
Aktivitete dhe gara jashtë shkollore	Gara	Shumë mirë Shkolla organizon gara interne për seleksionimin e nxënësve që do të marrin pjesë në gara në nivele më të larta. Nxënësit, me mbështetjen e shkollës dhe të mësimdhënësve, marrin pjesë në gara të ndryshme në nivel komunal, rajonal, shtetëror (të organizuara nga shoqatat e akredituara të mësimdhënësve) dhe ndërkombëtar, si dhe në aktivitete të tjera me karakter garues.

Dokumente

[Koncepte për aktivitete jashtë shkollore në arsimin fillor rajonal dhe shtetëror në arsimin fillor](#) (MASH, 2019 dhe 2020 - plotësim) (BZHA, 2020)

Burimet e të dhënave për aktivitete jashtëshkollore përfshijnë:

- Programin vjetor të punës së shkollës
- Programin për aktivitetet jashtëshkollore
- Raportet nga ekskursionet e realizuara
- Evidencën dhe dokumentacionin pedagogjik
- Diploma, mirënjohje dhe lëvdata nga pjesëmarrja në manifestime dhe gara
- Intervistat dhe anketat me mësimdhënës, prindër, nxënës dhe bashkëpunëtorë profesionalë për aktivitetet jashtëshkollore
- Procesverbalet nga aktivet profesionale dhe bashkësia e nxënësve
- Listat e nxënësve të përfshirë në aktivitete jashtëshkollore
- Qasja në faqen e internetit të shkollës, gazetatat, rrjetet sociale etj.

Sfera1: Planifikimi, mësimi dhe nxënia

Pjesërisht kënaq

Përshkrim / Përmbledhje e fushës:

Shkolla ofron trajnime për mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesionalë për përdorimin e metodave dhe teknikave bashkëkohore në planifikimin e mësimi. Megjithatë, diseminimi i njohurive nga këto trajnimet nuk bëhet gjithmonë në mënyrë të qëndrueshme, dhe nuk ka procedura të qarta për dhënien e mbështetjes për përmirësim të planifikimeve.

Analiza tregon se, ndonëse planifikimet shqyrtohen në fillim të vitit shkollor nga drejtori dhe bashkëpunëtorët profesionalë, mungesa e procedurave për mbështetje e kufizon mundësinë që mësimdhënësit të përmirësojnë praktikën e tyre në mënyrë sistematike. Për përmirësim, rekomandohet krijimi i një mekanizmi të qartë për dhënien e mbështetjes dhe diseminimin e praktikave të mira midis mësimdhënësve, për të siguruar një planifikim dhe realizim më të efektshëm të mësimi.

Mësimdhënësit së paku dy herë në gjysmëvjetor shkëmbejnë përvoja për planifikimet në kuadër të aktivëve profesionalë, duke përdorur edhe përvoja profesionale nga mediat e ndryshme dhe nga bashkëpunimi rajonal me shkolla të tjera. Planifikimet e një numri të madh të mësimdhënësve janë përmirësuar si rezultat i këtij shkëmbimi dhe përdorimit të përvojave profesionale nga mediat dhe bashkëpunimi rajonal me shkolla të tjera.

Mësimi në klasë dhe në të gjitha lëndët mësimore realizohet rregullisht dhe në vëllimin e përcaktuar. Në rast mungese të mësimdhënësit (pushimi i lindjes, pushimi mjekësor, etj.), mësimi zhvillohet pa probleme me kuadrin përkatës mësimor.

Aktivitetet dhe lëndët zgjedhore/të lira janë në përputhje me planet dhe programet mësimore, Doracakun për lëndët e lira zgjedhore në arsimin fillor dhe procedurat e përcaktuara në shkollë, duke përfshirë interesat e nxënësve.

Të gjithë mësimdhënësit përshtatin detyrat dhe aktivitetet me nevojat individuale arsimore të nxënësve. Në këtë kuadër, mësimdhënësit përdorin qasje dhe resurse të ndryshme për nxënie dhe mësim, duke mos u kufizuar vetëm në librat shkollorë dhe literaturën manuale shtesë. Për nxënësit me nevojë të veçanta arsimore (NVA), përdoren metodat dhe teknikën e përshtatura sipas nevojave të tyre.

Të gjithë mësimdhënësit sillen me nxënësit në mënyrë që të promovojnë pranimin, respektin, bashkëpunimin dhe mirëkuptimin. Një numër i madh i mësimdhënësve sigurojnë mundësi të barabarta për përfshirje dhe përfshijnë të gjithë nxënësit gjatë orëve mësimore.

Në shumicën e orëve mësimore, ekziston ndërveprim aktiv mes mësimdhënësve dhe nxënësve, i cili ndihmon në arritjen e qëllimeve të orës. Shumica e nxënësve raportojnë se kanë mundësi të shprehen lirshëm gjatë orëve të mësimi.

Ekipi inkluziv i shkollës dhe ekipi inkluziv për nxënësit janë formuar me aktvendim të drejtorit të shkollës dhe përditësohen rregullisht pas përfundimit të mandatit ose ndryshimeve në përbërjen e mësimdhënësve për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore (NVA). Ekipi inkluziv siguron mbështetje për përpilimin e Planeve Individuale Arsimore (PIA) në të gjitha lëndët, në përputhje me rregullativën ligjore.

Me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, aktivitetet mësimore dhe jashtëshkollore realizohen sipas Planeve Individuale Arsimore (PIA) dhe/ose programeve të modifikuara sipas rekomandimeve të KNF (Klasifikimi Ndërkombëtar i Funkcionalitetit). Shkolla bashkëpunon në mënyrë aktive me qendrën kompetente të resurseve për të avancuar mësimin për nxënësit me aftësi të kufizuara.

Mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesionalë janë të trajnuar për të planifikuar dhe realizuar mësim me nxënës me NVA.

EISH ndjek realizimin e aktiviteteve INA të PVPSH dhe aktivitetet e projektit të marra përmes granteve nga MASH-i. EISH plotëson rregullisht pyetësorët anketa për nevojat e Komisionit për avancimin e INA-s në MASH.

Nxënësit dhe prindërit përjetojnë shkollën si një mjedis të sigurt, por pjesërisht stimulues, inkluziv, interkulturor dhe motivues. Nxënësit nuk kanë qasje të plotë në materiale të ndryshme për nxënie.

Një numër i konsiderueshëm i mësimdhënësve, në bashkëpunim me bashkëpunëtorët profesionalë, përdorin teknika të ndryshme interaktive në procesin e mësimdhënies. Si rezultat, një pjesë e nxënësve me nevoja të ndryshme arsimore arrijnë qëllimet e planifikuara.

Shkolla zbaton politikat e paracaktuara të notimit, duke përfshirë edhe kodin e notimit, me qëllim kryesor mbështetjen e nxënies së secilit nxënës.

Mësimdhënësit përdorin metoda, forma dhe instrumente të ndryshme për të vlerësuar dhe ndjekur përparimin e nxënësve, duke siguruar transparencë dhe mundësi për përmirësim.

Të gjithë mësimdhënësit u japin rregullisht informacione kthyesë nxënësve për punën e tyre, diskutojnë me nxënësit për përparimin dhe arritjet e tyre dhe, sipas nevojës, i përfshijnë në mësimin shtesë ose plotësues.

Shkolla planifikon, por realizon vetëm pjesërisht aktivitetet e planifikuara jashtëshkollore. Aktivitetet jashtëshkollore janë të kufizuara sipas llojit dhe nuk reflektojnë gjithmonë në mënyrë të mjaftueshme nevojat dhe interesat e nxënësve.

Shkolla organizon gara shkollore për seleksionimin e nxënësve për gara në nivel më të lartë. Nxënësit, me ndihmën dhe mbështetjen e shkollës dhe të mësimdhënësve, marrin pjesë në gara në sfera të ndryshme, duke përfshirë gara komunale, rajonale, shtetërore dhe ndërkombëtare.

Anët e forta

- Ndjekja e rregullt e seminareve dhe trajnimeve nga ana e mësimdhënësve për planet dhe programet mësimore.
- Mësimdhënësit përgatisin rregullisht planifikimet tematike-vjetore.
- Aktivitetet për orët e lira realizohen përmes sekcioneve të ndryshme.
- Shkolla realizon mësim për drejtatënjeriut në mësimin klasor, përmes lëndës së shoqërisë dhe mësimin të lëndës Arsimimi Qytetar.
- Shkolla organizon aktivitete jashtëmësimore, aktivitete projektuese dhe aksione për ekskursione të nxënësve.
- Nxënësit përfshihen në aktivitetet jashtëmësimore në mënyrë të barabartë, pa dallim gjinie, shkalle arsimore, përfaqësimi etnik apo prejardhje sociale.
- Bashkëpunim ndër-etnik me shkollën partnere.
- Bashkëpunim me komunën, MASH, BZHA dhe institucione të tjera kompetente për përmirësimin e kushteve për mbarvajtjen e procesit edukativo-arsimor.

Anët e dobëta:

- Një numër i vogël nxënësish konsiderojnë se nuk marrin instruksione të qarta se çfarë duhet të mësojnë për notat e caktuara.
- Një numër i vogël nxënësish ndihen se nuk mund të shprehin lirshëm gjatë orëve mësimore.
- Një numër i vogël nxënësish nuk ndihen të përfshirë në mënyrë aktive në procesin mësimor, përmes pyetjeve, punës në grup apo diskutimeve.
- Mungesa e sallës sportive.
- Mungesa e kabineteve mësimore dhe e mjeteve didaktike për realizimin e mësimin bashkëkohor.

- Një pjesë e prindërve nuk tregojnë interes të mjaftueshëm për suksesin dhe sjelljen e fëmijëve të tyre.

Prioritetet e shkollës:

- **Kompletimi i kuadrit adekuat arsimor** – Sigurimi i mësimdhënësve në të gjitha lëndët për të garantuar një mësim cilësor dhe për të përmbushur nevojat individuale të nxënësve.
- **Sigurimi i stafit mbështetës** – Emërimi i zëvendës-drejtorit, logopedit dhe bibliotekistit, për të kontribuar në planifikimin, zhvillimin dhe monitorimin e aktiviteteve mësimore dhe jashtëmësimore.

Këto masa synojnë forcimin e kapaciteteve të shkollës dhe krijimin e një ambienti më inkluziv, stimulues dhe të përshtatshëm për nxënësit.

Metodat e përdorura për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave:

Anketa me prindërit/kujdestarët:

Pyetsor për prindërit – Planifikimi, Mësimi dhe Nxënia

Në kuadër të vetevaluimit të shkollës, u realizua një pyetsor me **90 prindër të anketuar**, për të mbledhur të dhëna

1. Shkolla më inkurajon të marrë pjesë në aktivitete të ndryshme shkollore?

PO 83.4%

JO 16.6%

2. Këshilli i shkollës shpall në mënyrë transparente vendimet e marra?

PO 61.1%

JO 38.9%

3. Stafi mësimor në shkollë është i cilësisë së lartë dhe kompetent?

PO 86.6%

JO 13.4%

4. Shkolla është një mjedis i sigurt për fëmijën tim?

PO 96.7%

JO 3.3%

5. Të drejtat e nxënësve respektohen për të gjithë njësoj?

PO 86 %

JO 14 %

6. Fëmija im në shkollë ka qasje në materiale të ndryshme mësimore (p.sh. enciklopedi, revista, internet etj.)?

PO 18.9%

JO 81.1%

7. Arsimitarët përdorin lëvdata për mundin dhe sukseset e arritura të fëmijës tim?

PO 65.5%

JO 34.5%

8. Rregullisht jam i informuar për arritjet e fëmijës tim në shkollë (3 mujor, gjysmëvjetor dhe fundvit)?

PO 100 %

JO 0 %

9. Arsimitarët më njoftojnë me kriteret e notimit në lëndët e tyre?

PO 21.1%

JO 78.9%

10. Fëmija im është i kyçur në aktivitetet jashtëmësimore sipas interesit të tij?

PO 12.2%

JO 87.8%

PYETSOR PËR MËSIMDHËNËSIT

Tema: *Planifikimi dhe Mësimdhënia*

Numri i të anketuarve: 52 mësimdhënës

1. A i merrni në kohë trajnimet për përdorimin e metodave dhe teknikave të reja për planifikimin e mësimdhënies?

PO 84.38%

JO 15.62%

2. A i ndjekin drejtori dhe shërbimi profesional planifikimet tuaja të paktën dy herë në gjysmëvjetor?

PO 82.0%

JO 18.0%

3. A shkëmbeni përvoja për planifikimet në kuadër të aktiveve profesionale të paktën dy herë në gjysmëvjetor?

PO 62.0%

JO 38.0%

4. A përdorni burime të ndryshme për mësimdhënie dhe mësimnxënie?

PO 82.0%

JO 18.0%

5. A përdorni në mësim qasje që nxisin hulumtimin dhe zgjidhjen e problemeve?

PO 60.0%

JO 40.0%

6. A i nxisni nxënësit të parashtrojnë pyetje kur nuk kuptojnë diçka ose duan të dinë më tepër?

PO 75.0%

JO 25.0%

7. A keni respekt ndaj të gjithë nxënësve?

PO 79.0%

JO 21.0%

8. A i organizoj orët e mësimi në mënyrë që nxënësit të bashkëpunojnë dhe të ndërveprojnë me njëri-tjetrin?

PO 75%

JO 25.%

9. A jepni rregullisht lëvdata nxënësve për sukseset e tyre dhe për mundin që kanë dhënë?

PO 83%

JO 17.%

10. A përdorni mënyra të ndryshme për vlerësimin e nxënësve?

PO 90%

JO 10.%

PYETËSOR PËR NXËNËSIT

Tema: *Planifikimi dhe Mësimdhënia*

Numri i të anketuarve: 100 nxënës

1. A keni mundësi të mësoni në mënyra të ndryshme gjatë orës (p.sh. përmes projekteve, lojërave, hulumtimeve etj.)?

PO 58%

JO 42%

2. A përdoren materiale të ndryshme gjatë mësimi (p.sh. enciklopedi, revista, internet etj.)?

PO 43%

JO 57%

3. Në shumicën e orëve, a jeni të gjithë nxënësit të angazhuar aktivisht në mësim (p.sh. diskutime, pyetje, përgjigje)?

PO 67%

JO 33%

4. A ju përkrahin dhe ju motivojnë mësimdhënësit të merrni pjesë në gara dhe projekte të ndryshme?

PO 64%

JO 36%

5. A ju japin mësimdhënësit shpjegime se përse keni marrë një notë të caktuar?

PO 82%

JO 18%

6. A mendoni se notimi është i drejtë për të gjithë nxënësit?

PO 79%

JO 21%

7. A përdorin mësimdhënësit mënyra të ndryshme për vlerësimin në njohuritë tuaja (p.sh. teste, vlerësim verbal, çeklista etj.)?

PO 83%

JO 17%

8. A ju lavdërojnë mësimdhënësit për mundin e dhënë dhe për rezultatet e arritura?

PO 71%

JO 29%

9. Gjatë orëve mësimore, a keni mundësi të parashtroni pyetje dhe të shprehni mendimin tuaj?

PO 89%

JO 11%

10. A zgjidhen lëndët zgjedhore dhe aktivitetet jashtëmësimore sipas interesave tuaja?

PO 87%

JO 13%

Sfera 2: Arritjet e nxënësve

Indikatori	Tema	Përshkruesit
Arritjet e nxënësve	“Ndjekja e arritjeve të nxënësve sipas gjinisë dhe gjuhës së mësimi, duke marrë parasysh lëndët mësimore dhe periudhat e klasifikimit.”	Pjesërisht kënaq “Shkolla përzgjedh, përdor dhe analizon të dhënat për arritjet e nxënësve sipas gjinisë dhe gjuhës së mësimi, duke përfshirë të gjitha lëndët mësimore dhe periudhat e klasifikimit. Megjithatë, nuk ndërmerren aktivitete të veçanta për përmirësimin e rezultateve. Pjesëmarrja dhe arritjet në aktivitete jashtëshkollore evidentohet.”
Arritjet e nxënësve	“Identifikimi dhe mbështetja e nxënësve me vështirësi në nxënie, të nxënësve të talentuar dhe të nxënësve me aftësi të kufizuara.”	Shumë mirë “Shkolla identifikon nxënësit e talentuar, nxënësit me vështirësi në nxënie, si dhe nxënësit me pengesa në zhvillim, dhe ndjek rregullisht përparimin e tyre. Nxënësit, periodikisht, marrin mbështetje për përmirësimin e arritjeve.”
Arritjet e nxënësve	“Njoftimi i prindërve / kujdestarëve për arritjet e nxënësve.”	Shumë mirë “Shkolla ka një sistem të përcaktuar për njoftimin e prindërve/kujdestarëve mbi përparimin e fëmijëve dhe e zbatojnë atë në mënyrë të rregullt. Prindërit/kujdestarët marrin informacion mbi arritjet e nxënësve pas çdo periudhe klasifikimi. Gjithashtu, ata kanë mundësinë të ndjekin arritjet e fëmijës së tyre përmes e-ditarit, i cili përdoret rregullisht.”

Burimet e të dhënave për vetëevaluim përfshijnë::

1. E-ditari
2. Procesverbalet nga mbledhjet prindërore
3. Analizat e arritjeve sipas kriterëve të ndryshme dhe periudhave të klasifikimit
4. Plani i veprimit për përmirësim
5. Anketa me nxënës, mësimdhënës dhe prindër
6. Intervista me bashkëpunëtorë profesionalë dhe drejtorin

Masa për përmirësimin e arritjeve	Rregullsia në mësim	Shumë mirë “Shkolla ndjek në mënyrë sistematike rregullsinë e nxënësve, analizon arsyet e mungesave nga mësimi dhe ndërmerr aktivitete konkrete për përmirësimin e saj. Bashkëpunon me prindërit/kujdestarët, institucionet (MPPS, qendrat për punë sociale etj.), vetëqeverisjen lokale dhe organizatat qytetare, me qëllim rritjen e rregullsisë së nxënësve në mësim. Numri mesatar i mungesave të paarsyeshme midis dy evaluimeve integrale është më pak se pesë për nxënësit. Shkolla ndërmerr masa veçanta për ndjekjen e rregullt të mësimin nga nxënësit e kategorive të rrezikuara, të cilat japin rezultate të matshme.”
Masa për përmirësimin e arritjeve	Këshillim i prindërve / kujdestarëve dhe nxënësve	Shumë mirë “Shkolla realizon këshillimet me prindër/kujdestarë dhe nxënësit, për çka udhëheq dokumentacion të rregullt, informon institucionet kompetente, analizon rezultatet e këshillimeve dhe ndjek përmirësimin e rregullsisë, suksesit dhe sjelljes së nxënësve. Këshillimet me prindër/kujdestarë rezultojnë në përmirësimin e arritjeve të nxënësve, ndërsa këshillimet me nxënësit, kur realizohen në numër të madh, kontribuojnë në përmirësimin e suksesit, rregullsisë dhe sjelljes së tyre.”
	“Përmirësimi i arritjeve të nxënësve përmes mësimin të rregullt dhe plotësues.”	Pjesërisht kënaq “Vetëm një numër i vogël i mësimdhënësve përdorin metoda, teknika dhe strategji për përmirësimin e arritjeve të nxënësve. Gjatë vitit nuk ka ndryshime të dukshme në realizimin e mësimin në drejtim të përmirësimin të arritjeve. Shkolla, në nivel mujor, përpilon orar për mësim plotësues, por ai realizohet kryesisht në fund të vitit shkollor dhe vetëm për lëndë të caktuara mësimore. Shkolla nuk analizon rezultatet nga mësimin plotësues dhe/ose diferencuar nga aspekti i kontributit të tij drejt arritjeve të nxënësve.”

Burimet e të dhënave:

1. Procesverbalet nga këshillimet me prindër dhe nxënës
2. Orari dhe lista e mësimit plotësues dhe shtuesë
3. E-ditari

Sfera 2: Arritjet e nxënësve

Pjesërisht kënaq

“Përshkrim/Përmbledhje e fushës (sferës)”

“Shkolla përzgjedh, përdor dhe analizon të dhënat për arritjet e nxënësve sipas gjinisë dhe gjuhës së mësimit, duke përfshirë të gjitha lëndët mësimore dhe periudhat e klasifikimit, por nuk ndërmerr aktivitete të veçanta për përmirësim. Pjesëmarrja dhe arritjet në aktivitete jashtëshkollore evidentohet. Shkolla ka marrë pjesë në teste ndërkombëtare si TIMSS, PIRLS dhe QPSh, ku rezultatet nuk kanë qenë shumë të mira. Rezultatet nga testimet shtetërore dhe studimet/raportet për vlerësime ndërkombëtare mblidhen, por nuk analizohen. Shkolla ka një sistem të përcaktuar për njoftimin e prindërve mbi përparimin e fëmijëve dhe e zbatojnë atë në mënyrë të përpiktë. Prindërit/kujdestarët marrin informacion mbi arritjet e nxënësve pas çdo periudhe klasifikimi dhe kanë mundësinë të ndjekin arritjet e fëmijës së tyre përmes e-ditarit, i cili përdoret rregullisht.”

“Shkolla ndjek sistematikisht rregullsinë e nxënësve, analizon mungesat dhe ndërmerr aktivitete konkrete për përmirësim. Bashkëpunon me prindërit, institucionet kompetente dhe organizatat qytetare për të rritur rregullsinë dhe suksesin e nxënësve, veçanërisht të atyre në kategori të rrezikuara. Shkolla realizon këshillime me prindër dhe nxënës, dokumenton rezultatet dhe ndjek përmirësimin e rregullsisë, suksesit dhe sjelljes. Këshillimet me prindër kontribuojnë në përmirësimin e arritjeve, ndërsa ato me nxënës ndihmojnë në përmirësimin e suksesit, rregullsisë dhe sjelljes.”

“Vetëm një numër i vogël i mësimitdhënësve përdorin metoda, teknika dhe strategji për përmirësimin e arritjeve të nxënësve. Gjatë vitit nuk ka ndryshime të dukshme në realizimin e mësimit në drejtim të përmirëimit të arritjeve. Shkolla, në nivel mujor, përpilon orar për mësim plotësues, por ai realizohet kryesisht në fund të vitit shkollor dhe vetëm për lëndë të caktuara. Shkolla nuk analizon rezultatet nga mësimi plotësues dhe/ose diferencuar në aspektin e kontributit të tij drejt arritjeve të nxënësve.”

Anët e forta:

- Shkolla përzgjedh, përdor dhe analizon të dhënat për arritjet e nxënësve sipas gjinisë dhe gjuhës së mësimi, duke përfshirë të gjitha lëndët mësimore dhe periudhat e klasifikimit.
- Prindërit/kujdestarët marrin informacion mbi arritjet e nxënësve pas çdo periudhe kualifikimi dhe mund të ndjekin arritjet e fëmijës së tyre përmes e-ditarit, i cili përdoret rregullisht.
- Shkolla ndjek në mënyrë sistematike rregullsinë e nxënësve, analizon arsyet e mungesave nga mësimi dhe ndërmerr aktivitete konkrete për përmirësimin e saj.
- Shkolla realizon këshillime me prindër/kujdestarë dhe nxënës, udhëheq dokumentacion të rregullt dhe ndjek përmirësimin e rregullsisë, suksesit dhe sjelljes.
- Shkolla identifikon nxënësit e talentuar, nxënësit me vështirësi në nxënie dhe nxënësit me pengesa në zhvillim, dhe ndjek rregullisht përparimin e tyre.
- “Shumica e nxënësve janë të rregullt në mësim.”

Anët e dobëta:

- Rezultatet e nxënësve në testimet shtetërore dhe ndërkombëtare (TIMSS, PIRLS, QPSh) nuk janë të kënaqshme.
- Realizimi i mësimi shtues dhe plotësues është i kufizuar dhe kryesisht në fund të vitit shkollor.
- Një numër i vogël i mësimdhënësve përdorin metoda, teknika dhe strategji për përmirësimin e arritjeve të nxënësve.

Prioritetet:

- Nxitja e mësimdhënësve për përdorimin e metodave të reja mësimore, mësimi interaktiv, punës në grupe etj.
- Krijimi i kushteve për realizimin e mësimi shtues dhe plotësues.

“Metodat që përdoren për përmbledhjen e të dhënave dhe informacionit të përpunuar.”

“Anketa me mësimdhënësit

Pyetësor për mësimdhënësit mbi arritjet e nxënësve – 52 mësimdhënëës të anketuar.”

1. A arrini të identifikoni nxënësit me vështirësi në nxënie?

PO 84%

JO 16%

2. A arrini të identifikoni nxënësit e talentuar?

PO 72%

JO 28%

3. A e shfrytëzojnë një numër i madh i prindërve mundësinë për t’ju kontaktuar për arritjet e fëmijëve të tyre në lëndën tuaj?

PO 54%

JO 46%

4. A u jepni prindërve udhëzime të qarta se si mund të ndihmojnë fëmijët e tyre në mësim?

PO 63%

JO 37%

“Anketa për nxënësit

Pyetësor për nxënësit mbi arritjet e tyre – 100 nxënës të anketuar.”

1. A janë prindërit e mi vazhdimisht të informuar për përparimin tim në mësim?

PO 76%

JO 24%

2. Mësimdhënësit gjithmonë më nxisin për përmirësimin e suksesit tim?

PO 75%

JO 25%

3. Nëse nuk arrij të përvetësoj materialin mësimor, me kërkesën time mësimdhënësit më organizojnë mësim plotësues?

PO 30%

JO 70%

4. Nëse nuk arrij të përvetësoj materialin mësimor, a përpiqen mësimdhënësit të më shpjegojnë në mënyra të ndryshme?

PO 49%

JO 51%

5. Nëse në ndonjë lëndë dua të mësoj më tepër nga ajo që mësoj në orë, mësimdhënësit më ofrojnë mësim shtuesë?

PO 33%

JO 67%

“Anketa për prindërit

Pyetësor për prindërit mbi arritjet e nxënësve – 90 prindër të anketuar.”

1. A marrë nga shkolla këshilla të mira për përmirësimin e suksesit të fëmijës tim?

PO 74%

JO 26%

2. A marrë nga shkolla këshilla të mira për përmirësimin e sjelljes së fëmijës tim?

PO 77%

JO 23%

3. A më informon shkolla rregullisht për rregullshmërinë e fëmijës tim?

PO 84%

JO 16%

4. A i mundësohet fëmijës tim realizimi i mësimin shtues dhe plotësues nëse ka nevojë?

PO 28%

JO 72%

Sfera 2 – arritjet e nxënësve

Intervist me drejtorin dhe shërbimin profesional

1. A analizon shkolla të dhënat për arritjet e nxënësve sipas gjinisë dhe gjuhës së mësimi, për të gjitha lëndët mësimore dhe për të gjitha periudhat e kualifikimit? Po gjithmonë

a) Çfarë tregojnë rezultatet?

“Të dhënat tregojnë numrin e meshkujve dhe femrave në të gjitha klasat dhe paralelet, arritjet e nxënësve në çdo lëndë mësimore, numrin e notave negative për nxënës, si dhe lëndët ku janë marrë këto nota. Të dhënat mbledhen për çdo periudhë të kualifikimit.”

b) Si veprojnë pas përpunimit të të dhënave? Çfarë ndërmerreni për përmirësimin e rezultateve (p.sh., suksesit të ulët në lëndë të caktuara)?”

“Pas raportit të Këshillit Arsimor, i cili mbahet çdo 3 muaj, në rast të suksesit të ulët të nxënësve thirren në këshillim prindërit dhe nxënësit. Nxënësit këshillohen nga psikologu dhe pedagogët, ndërsa zhvillohen edhe biseda me kujdestarët e klasave.”

